



## DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

### **Shënim metodologjik mbi pritjet për inflacionin**

#### **Qëllimi i vlerësimit të pritjeve për inflacionin**

Pritjet për inflacionin janë një tregues i rëndësishëm për bankat qendrore pasi ato ndikojnë vendimmarrjen e agjentëve ekonomikë për konsum dhe investime. Zgjerimi apo tkurrja e konsumit dhe e investimeve reflektohet në kërkesën agregate dhe në presionet që krijon kërkesa tek ecuria e inflacionit. Për bankat që kanë adoptuar strategjinë e shënjestrimit të inflacionit - e cila në vetvete është një strategji paraprijëse, - pritjet për inflacionin marrin interes të veçantë. Ato janë tregues edhe i besueshmërisë së publikut te banka qendrore - te arritja e objektivit për inflacionin, me qëllim ruajtjen e stabilitetit afatmesëm të çmimeve të konsumit. Nëse agjentët ekonomikë besojnë se banka qendrore do të reagojë për ta çuar inflacionin në objektiv, atëherë pritjet e tyre inflacioniste do të ishin të ankoruara pranë këtij objektiv. Në këto kushte, edhe vendosja e çmimeve dhe e pagave do të tentonte të ishte në linjë me objektivin për inflacionin, duke rezultuar një proces pak i ndikuar nga luhatjet afatshkurtra të inflacionit faktik. Në të kundërt, në rastin kur pritjet inflacioniste nuk do të ishin në linjë me objektivin për inflacionin, arritja e stabilitetit të çmimeve do të rezultonte më e vështirë. Në këtë mënyrë, roli i pritjeve për inflacionin, duhet të shtrihet jo vetëm në rritjen e besueshmërisë, por edhe në procesin e modelimit dhe parashikimit afatmesëm të inflacionit.

Pritjet inflacioniste nuk mund të maten në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në ndryshim nga vetë inflacioni, ato bëjnë pjesë në grupin e variablave të pamatshëm apo të pavrojtueshëm drejtpërdrejt nga statistikat zyrtare. Si të tilla, pritjet vlerësohen me metoda të tërthorta. Ndër më të përdorurat është ajo e mbledhjes së tyre nëpërmjet vrojtimeve pranë agjentëve ekonomikë.



## DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

### **Vlerësimi i pritjeve për inflacionin në rastin e Shqipërisë**

Në rastin e Shqipërisë, pritjet për inflacionin vlerësohen nga Banka e Shqipërisë, në bazë të të dhënave të marra nga vërtetimi i bizneseve dhe i konsumatorëve në kuadrin e Vërtetimeve të Besimit<sup>1</sup> dhe të vërtetimit të Agjentëve Financiarë<sup>2</sup>. Vlerësimet që merren janë të formës cilësore dhe sasiore tek Vërtetimet e Besimit, dhe vetëm sasiore në rastin e Vërtetimit të Agjentëve Financiarë. Pritjet për inflacionin vlerësohen për horizonte të ndryshme kohore përtej momentit që kryhet vërtetimi dhe me frekuenca të ndryshme.

Në rastin e bizneseve dhe të konsumatorëve, vërtetohen pritjet për inflacionin vjetor pas një viti. Pra, nga Vërtetimet e Besimit merret informacion për pritjet për inflacionin në një horizont afatshkurtër. Në rastin e vërtetimit të Agjentëve Financiarë, në një prej seksioneve kërkohet vlerësimi pikësor mbi normën e pritur të inflacionit pas 1-, 2- dhe 3-vitesh, duke mbuluar horizontin kohor nga afatshkurtër në afatmesëm. Frekuenca e këtij vërtetimi është mujore.

Mbledhja e informacionit përmes vërtetimeve pasohet nga procesi i sistemimit dhe i përpunimit të informacionit deri në agregimin e tij në një nivel mesatar për secilin grup të vërtetuar. Paraqitja grafike dhe analiza e pritjeve për inflacionin janë pjesë e raporteve të politikës monetare dhe e punës kërkimore në Bankën e Shqipërisë.

Pritjet sasiore të konsumatorëve për inflacionin kanë filluar të maten duke filluar nga viti 2005, të bizneseve nga viti 2009, dhe të agjentëve financiarë nga viti 2008. Gjatë viteve, metodologjitë për vlerësimin e pritjeve për inflacionin nga vërtetimet janë përsosur dhe do të vijojnë të përshtaten me praktikën më të mirë ndërkombëtare. Për çdo ndryshim do të vendoset shënimi sqarues në seritë përkatëse. Në seksionin e serive kohore gjëni formën e pyetjeve sasiore, respektivisht për konsumatorët, bizneset dhe agjentët financiarë.

---

<sup>1</sup> Për më tepër lidhur me Vërtetimet e Besimit, referojuni rubrikës së Vërtetimit të Besimit të Bizneseve dhe të Konsumatorëve.

[https://www.bankofalbania.org/Politika\\_Monetare/Vërtetimet/Vërtetimi\\_i\\_bizneseve\\_dhe\\_i\\_konsumatoreve/](https://www.bankofalbania.org/Politika_Monetare/Vërtetimet/Vërtetimi_i_bizneseve_dhe_i_konsumatoreve/)

<sup>2</sup> Në këtë vërtetim pyeten institucione financiare banka dhe jobanka.